



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-70

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve dhe duke vendosur sipas kërkesës me nr. 05-350/02-18402/22 dt. 27.01.2022 të pronarit Milazim Zeqiraj, lagja “Sofalia” në Prishtinë për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë për banim individual në bllokun F-02, të tërësisë urbane “F” të Planit Rregullues të Hollësishtëm “Sofalia” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 14.06.2022, merr këtë:

## V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I caktohen kushtet ndërtimore** pronarit Milazim Zeqiraj nga Prishtina, sipas kërkesës me nr. 05-350/02-18402/22 dt. 27.01.2022, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë për banim individual me etazhitet B+S+P+1, të bllokut “F-02” të tërësisë urbane “F”, të Planit Rregullues të Hollësishtëm “Sofalia” në Prishtinë, në parcelen kadastrale nr. 00427-4, Z.K Sofali.

**II. Lokacioni** për të cilin caktohen kushtet ndërtimore gjendet në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishtëm “Sofalia”, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-247790 të dt. 04.10.2016, ku sipas këtij plani, kjo zonë është e planifikuar për “banim individual”, Lidhur me këtë dhe me parametrat e ndërtimit nga ky plan, pronari është informuar me “Informim nga Plani Rregullues i Hollësishtëm –Sofalia 2016-2024” me nr.04-350/01-169178/21 dt. 23.08.2021 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm – Prishtinë.

**III. Gjendja ekzistuese e lokacionit** - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
  - nr. 00427-4, me S= 400 m<sup>2</sup>, me pronar Milazim Zeqiraj, tokë bujqësore – arë e klasës 6.
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe çertifikatës së njësisë kadastrale;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka një ramje të konsiderueshme në raport me rrugën;
- Parcela kadastrale ka qasje në rrugën ekzistuese e cila njëkohësisht është edhe rrugë e planifikuar sipas këtij Plani Rregullues;
- Në diametër prej 50 m' ka shtëpi të ndërtuara, kryesisht me destinim "banimi".

**IV. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Vija ndërtimore ndaj vijës rregulluese, pozicionimi dhe gabariti i ndërtesës, dhe kushtet tjera për rregullimin e parcelës ndërtimore të jenë në tërësi sipas Planit Rregullues të Hollësishtëm “Sofalia”, dhe sipas prezantimit grafik të prezantuar në dokumentacionin ndërtimor.

- Parcela minimale për ndërtim sipas Planit Rregullues të Hollësishëm „Sofalia” është 400m<sup>2</sup> me përjashtim të parcelave më të vogla, ndarjet e të cilave kanë ekzistuar para fillimit të hartimit të Planit Rregullues.
- Etazhiteti i ndërtesës, sipas planit rregullues është P+2, kurse i propozuar dhe i miratuar është B+S+P+1;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, është banim individual i ulët,
- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP), është max.0.30 e sipërfaqes së parcelës;
  - $S = 400 \text{ m}^2 \times 0.3 (30\%) = 120 \text{ m}^2$  / sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”,
  - $S = 119.35 \text{ m}^2$  / sipas projekt propozimit;
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISPN), është max.0.8;
  - $S = 400 \text{ m}^2 \times 0.8 (80\%) = 320 \text{ m}^2$  / sipas “Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”,
  - $S \sim 300 \text{ m}^2$  / sipas projekt propozimit, sipërfaqe mbitokësore;
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHN), max. 0.5, ndërsa pjesa e bodrumit që del jashtë gabaritit të objektit në përdhese nuk duhet të jetë mbi nivelin e tokës”, është max 0.5 (50 %);
- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISG) min 0.5;
- Qasja në parcelë duhet të jetë nga rruga ekzistuese;
- Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës ,për kthina primare min 0.5 H,për kthina sekundare min.0.2 H;
- Nëse në fasadat e ndërtesës me orientim nga fqinjët kanë hapje sekondare si shkallë,depo,banjo e të tilla kthina të ngjashme, të cilat nuk kanë nevojë për diellzim, por vetëm për ndriçim dhe ajrosje, distanca minimale është 0.2h nga kufiri i parcelës.
- Nëse në fasadat e ndërtesës me orientim nga fqinjët nuk kanë hapje ndriçim distanca minimale është 0.2h nga kufiri i parcelës.Por me pëlqim paraprak të fqinjëve, kjo distancë mund të zvogëlohet deri në bashkimin e plotë.
- Kuota e përdhese së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e niveletës së rrugës publike nga e cila ka çasje parcela,gjegjësisht në krahasim me kuotën zero;
- Kuota e përdhese së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se kuota e niveletës së rrugës publike;
- Kuota e përdhese mund të jetë më së shumti 1,4 m mbi kuotën e rrugës nga e cila ka çasje.
- Distanca në mes vijës ndërtimore dhe asaj rregulluese është 5.0 m.
- Nëse parcela ka pjerrtësi tereni i tillë që mbulon më shumë sesa një kat në njërin drejtim,atëherë sipërfaqja ndërtimore llogaritet 50%,
- Me kërkesë të posaçme dhe duke marrë pëlqimin e qytetarëve në rreze prej 50m, mund të lejohet edhe ndërtimi i shërbimeve të tjera jo shqetësuese, me qëllime afariste, ndërmarrje tregtare, zejtare, fetare, kulturore, sportive etj duke përfshirë edhe hapësirat shërbuese.
- Për të siguruar pamje të përshtatshme dhe të organizuar të kulmeve në zonë, këndi i kulmeve të pjerrëta është kufizuar në maksimum 45°;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që uji i strehëve duhet të pikojë brenda parcelës kadastrale;
- Pamja e rrugës përcaktohet nga ndërtesat e ndërtuara, por në mënyrë vendimtare edhe nga lartësia e mureve fqinje, gardheve, dhe rrethimeve tjera. Për ta parandaluar ndërhyrjen pamore të hapësirës së rrugës, lartësia është kufizuar në 1,5 m.
- Te shtëpitë për banim individual parashihet 1 vendparkim/njësi banimi.
- Gjatë ndërtimit të ndërtesës, ndërtesat fqinje të sigurohen me masat mbrojtëse adekuate.
- Arkitektura e ndërtesës së re t'i përshtatet ambientit që e rrethon dhe vlerave ambientale;
- Para aplikimit për Leje ndërtimore, duhet të aplikoni për “Leje të rrënimt” të objektit ekzistues, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 00427-4 ZK Sofali.
- Para aplikimit për leje ndërtimore parcela duhet të lirohet nga hipoteka ose të sigurohet pëlqimi prej bankës.

**V. Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

**VI. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme.

**VIII. Paga e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela kadastrale nr. 00427-4 ZK Sofali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës, tokë bujqësore – arë e klasës 6, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – "zgjdhja urbane", duke llogaritur sipërfaqen e parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulative të përcaktuar me Planin rregullues. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**IX. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

**IX. Pagesa e taksës administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës**, do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

**X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore** do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimin për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

### A r s y e t i m

Aplikuesi, Milazim Zeqiraj nga Prishtina, me kërkesën nr. 05-350/02-18402/22 dt. 27.01.2022, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë për banim individual me etazhitet B+S+P+1 në lokacionin e përkrahur si në pikën I të dispozitivit të këtyre Kushteve ndërtimore.

Bashkangjitur me kërkesë aplikuesi ka prezantuar: provën mbi të drejtën pronësoro-juridike në lokacionin në fjalë, për parcelen kadastrale nr. 00427-4 ZK Sofali, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914066-00427-4 Z.K Sofali të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës, vërtetimin e tatimit në pronë nr.18321/22 dt.27.01.2022 në emër të Milazim Zeqiraj, “Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm –Sofalia 2016-2024” me nr.04-350/01-169178/21 dt. 18.08.2021 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm – Prishtinë, inçizimin gjeodezik për parcelën kadastrale nr. 00427-4 të punuar nga gjeodeti i licencuar Durim Hoxha, me nr.të licencës 183 dt.18.02.2018, projekt propozimi për kushte ndërtimore, hartuar nga N.N.SH “Vizion Projekt” me numër unik identifikues 810540345 dt.03.03.2008 dhe kopja e letërnjoftimit e Milazim Zeqiraj.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 05-350/02-18402/22 dt. 27.01.2022, kritereve të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, si dhe nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosur njoftimin publik me datë 30.03.2022. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë 5 ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, ka konstatuar se propozimi për kushte ndërtimore është konform kritereve të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-247790 të dt. 04.10.2016, nenit 17 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012 si dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte dhe leje ndërtimore.

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkangjitura, konsultimit të planeve urbanistike për hapësirën ku gjendet lokacioni si dhe të rregullativës ligjore nga lëmi i ndërtimit dhe asaj nga

lëmi i procedurës së përgjithshme administrative, konstatoi se, janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për lëshimin e këtyre Kushteve Ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacioni - "zgjidha urbane" për shtëpinë e planifikuar dhe hapësirat përcjellëse; Situacioni i parcelave kadastrale në raport me rrugën e planifikuar, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga PRRU "Safalia" në sistemin koordinativ KosovaREF 01.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror – MMPHI.

**Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet:** Aplikuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 nr.350/02-18402/22 dt. 27.01.2022

**Kopja elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 350/02-18402/22 DT. 14.06.2022**

Zyrtari,  
Mejrushe Sejdullahu



U.d. e udhëheqëses së sektorit,  
Nazife Krasniqi








Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:  
Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_



Prishtinë: 30.05.2022

Legjenda:

- Vija Irreguljese sipas PRRU
- - - - - Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcela Kodastrore







FURNIZIMI DHE LLOJI I VEGJETACIONIT

1. BREDHA
2. SHKURRE DEKORUESE (THUJA OCC-GOLDEN GLOBE)
3. DRU DEKORATIV "ACER VARIEGATUM" dru gjethrënës
4. DRU DEKORATIV "DRU JAPONEZ - KUMBULL JAPONEZE"

PËRQINDJA E SIPËRFAQEVE NË PARCELA		SIP. TE PROJEKTUARA	
EMËRTIM	SIP. (M2)	SIP. (%)	BODRUMI
OBJEKT (SHPUTA NËNTOKË)	154.23	38.56%	SUTERENI NEN TOKE
OBJEKT (SHPUTA MBITOKË)PERDHESA	119.35	29.84%	SUTERENI MBI TOKE
RRUGE, TROTUARE	25.00	6.25%	PERDHESA
			KATI I
GJELBRIM	255.65	63.91%	
TOTAL / BRENDA V. RREGULLUESE/	400.00	100.00%	TOTAL NEN TOKE
TOTAL / JASHT V. RREGULLUESE/	0.00		TOTAL MBI TOKE
			TOTAL

TABELA E KALKULIMIT TE SIPERFAQEVE SIPAS PLANIT PRRU "SOFALIA"						
NR. I PARCELES	SIP. TOTALE MBRENDA VIJES E PARCELES RREGULLUESE	SIP. PARCELES MBRENDA VIJES RREGULLUESE	SIP. PARCELËS JASHT VIJES RREGULLUESE	ISPN	SIPËRFAQE TOTALE E LEJUAR NE SHPUTE NDERTIMORE	SIP. E LEJUAR NE SHPUTE BODRUM 50%
00427-4	400.00	400.00	0.00	0.8	320.00	200.00
	400.00	400.00	0.00	0.8	320.00	200.00

INVESTITORI:		INVESTOR:	
OBJEKTI: BUILDING:		OBJEKTI: BUILDING:	
VENDI I NDERTIMIT: LOCATION:		VENDI I NDERTIMIT: LOCATION:	
PROJEKTUES: PROJECT DESIGN:		PROJEKTUES: PROJECT DESIGN:	
FAZA: PHASE:		FAZA: PHASE:	
PROJEKTI: PROJECT:		PROJEKTI: PROJECT:	
EMRI I FLETËS: SHEET/NAME:		EMRI I FLETËS: SHEET/NAME:	
Formati: Paper Size:		Formati: Paper Size:	
Perpjesa: Scale:		Perpjesa: Scale:	
Data: Date:		Data: Date:	

**PROJEKTOI:**  
PROJECTED BY:

**VIZION PROJECT**  
Project, construction, consulting, GIS, engineering

Adresat: Bregu i Diellit,  
10000, Prishtine  
Cel: +377(0)45 222 888.  
E-mail: vizionproject@yahoo.com

**MILAZIM ZEQIRAJ**

SHTEPI BANIMI B+S+P+I

Parcela 00427-4/ ZK Sofali, PRISHTINE

Shkelqim OSMANU, Jda

Premton GJONBALAJ, Jda

**ARKITEKTURA**

**IDEORE**

**SITUACIONI I INGSUSHTE**

Perpjesa: Scale: A3(420/297)mm

Data: Date: 2022

04